



KUJTESA NET

Fiton PEJA

Pronar

Prishtinë

Rasti Nr. 2019/68

Ref:1910/1275/KPM/mf

VENDIM

Lidhur me Ankesën Nr. 2019/68 – ARTMOTION (“Pala Ankuese”) kundër KUJTESA NET (“Pala Përgjegjëse”)

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) ka miratuar Rregulloren për Shpërndarjen e Ofriuesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2016/01, e cila ka hyrë në fuqi më 28 korrik 2016. Me këtë Rregullore janë përcaktuar rregullat dhe procedurat për shpërndarjen e ofriuesve të shërbimeve mediale nga ana e operatorëve, të cilët pavarësisht teknologjisë së përdorur, shpérndajnë përbajtje audio dhe audiovizuale.
2. KPM me datën 4 korrik 2019 ka pranuar një ankesë të parashtruar nga Pala Ankuese ndaj Palës Përgjegjëse. Pala Ankuese pretendon se Pala Përgjegjëse është duke i ritransmetuar disa kanale turke si: A HABER, TGRT HABER, TRT 1, TRT HABER, TRT TURK, TRT MUZUIK, TRT BELGESEL pa të drejta të ritransmetimit, kanale për të cilat Pala Ankuese posedon të drejtat ekskluzive të transmetimit për Territorin e Republikës së Kosovës.
3. KPM nëpërmes një shkresë me datën 16 gusht 2019, e ka njoftuar Palën Përgjegjëse për ankesën e pranuar nga Pala Ankuese dhe e ka udhëzuar që brenda afatit dhjetë ditësh të ofrojë dëshmi shtesë për të drejtën e ritransmetimit të kanaleve turke të sipërpërmendura.
4. KPM me datën 2 shtator 2019, ka pranuar përgjigje nga ana e Palës Përgjegjëse lidhur me shkresën duke pretenduar se për të drejtën e ritransmetimit të kanaleve turke ka deponuar marrveshjen që ka me operatorin D.P.SH. EAGLE përmes të cilës ka siguruar të drejtat e transmetimit.
5. KPM nëpërmes një shkresë me datën 12 shtator 2019, me qëllim të sqarimit të kësaj çështje, ka kërkuar nga Pala Përgjegjëse që në afat prej 10 ditësh të deponoj në KPM autorizimet/konfirmimet nga ana e kanaleve A HABER, TGRT HABER, TRT 1, TRT HABER, TRT TURK, TRT MUZIK, TRT BELGESEL, të cilat do të dëshmonin se

dhënësi i të drejtave TUYAD/Uydu Elektronik Iletisim Isinsanlari Dernegi e ka të drejtën e rishitjes së tyre në territorin e Kosovës përmes operatorit D.P.SH EAGLE.

6. KPM me datën 23 shtator 2019, ka pranuar pergjigje nga ana e Palës Përgjegjëse ku thuhet së brenda një periudhe të shkurt kohore, përmes operatorit D.P.SH. EAGLE do ti sigurojnë autorizimet/konfirmimet të cilat dëshmon se dhënësi i të drejtave TUYAD/Uydu Elektronik Iletisim Isinsanlari Dernegi e ka të drejtën e rishitjes në territorin e Kosovës përmes operatorit të shperndarhjes D.P.SH. EAGLE.
7. KPM me datën 4 tetor 2019, i ka dërguar një Njoftim Palës Përgjegjëse përmes të cilës e ka njoftuar për shkeljet e bëra dhe ka kërkuar të veprojë në pajtim me Rregulloren KPM-2016/01 duke i larguar kanalet turke A HABER, TGRT HABER, TRT 1, TRT HABER, TRT TURK, TRT MUZUIK, TRT BELGESEL nga transmetimi menjëherë pas pranimit të kësaj letre, në të kundërtën Komisionit i KPM-së do të ndërmarrë masa ligjore ndaj Palës Përgjegjëse, në pajtim me nenin 30 të Ligjit të KPM-së.
8. KPM me datë 7 tetor 2019, ka pranuar një përgjigje nga Pala Përgjegjëse në të cilën thuhet se është e interesuar që kjo qështje të zgjidhet dhe kërkon nga KPM që t'i drejtohet operatorit të shpërndarjes D.P.SH.EAGLE që të marrin informata të këkruara dhe do e dëshmojnë që e kanë të drejten e rishitjes së kanaleve turke të cekura më lartë për territorin e Kosovës.

Analiza Ligjore

9. Komisioni bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e kartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse ka vepruar në kundershtim të nenit 4, paragrafi 1, dhe nenit 5, paragrafi 3, të Rregullores KPM-2016/01.

Neni 4, paragrafi 1, i Rregullores KPM-2016/01 përcakton se:

“I licencuari obligohet të bëjë shpërndarjen e ofruesve të shërbimit medial bazuar vetëm në marrëveshje valide për shpërndarjen e shërbimeve mediale audio dhe audiovuzuale.”

10. KPM ka gjetur se edhe përkundër kërkeseve të KPM-së për respektim të të drejtës së transmetimit Pala Përgjegjëse ka vazhduar të veprojë në kundërshtim me nenin 4, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2016/01, duke i transmetuar kanalet turke pa marrëveshje valide.
11. KPM ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka dështuar të sigurojë dëshmi shtesë përmes të cilave do të dëshmonte se ka siguruar të drejtat e transmetimit të kanaleve A HABER, TGRT HABER, TRT 1, TRT HABER, TRT TURK, TRT MUZUIK, TRT BELGESEL. Pala Përgjegjëse ka deponuar një marrëveshje me operatorin DPSH EAGLE, mirëpo ka dështuar të sigurojë dëshmi shtesë autorizime/konfirmime nga kanalet turke se dhënësi i të drejtave TUYAD/Uydu Elektronik Iletisim Isinsanlari Dernegi e ka të drejtën e rishitjes në territorin e Kosovës përmes operatorit të shpërndarjes D.P.SH. EAGLE.

12. KPM gjithashtu ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka vepruar edhe në kundërshtim me nenin 5, paragrafi 3, të Rregullores KPM-2016/01 i cili përcakton se:

“Kur i licencuari gjen se një shërbim i programit ka përbajtje ilegale, i licencuari duhet menjëherë ta ndërpresë shpërndarjen e mëtutjeshme të përbajtjes ilegale dhe të ndërmarrë masa që të sigurohet se një gjë e tillë nuk do të përsëritet”

13. Komisioni i KPM-së konstaton se Pala Përgjegjëse ka dështuar të marr hapat e nevoshjme për të vepruar në pajtueshmëri të nenit 4, paragrafi 1, dhe të nenit 5, paragrafi 3, të Rregullores KPM-2016/01.

Vendimi

14. Komisioni, urdhëron Palën Përgjegjëse që të ndërpresë menjëherë ritransmetimin e kanaleve turke: A HABER, TGRT HABER, TRT 1, TRT HABER, TRT TURK, TRT MUZUIK, TRT BELGESEL në mënyrë që të veprojë në pajtim me nenin 4, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2016/01.

15. Pala Përgjegjëse sanksionohet me *Vërejtje* në pajtim me nenin 30, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së për shkelje të nenit 4, paragrafi 1të Rregullores KPM-2016/01.

16. Nëse Pala Përgjegjëse pas plotfuqishmërisë së këtij vendimi nuk i heq kanalet turke të lartpërmenduara nga platforma e shpërndarjes , Komisioni i KPM-së do të ndërmarrë masa tjera sanksionuese ndaj Palës Përgjegjëse në pajtueshmëri me nenin 30 të Ligjit të KPM-së.

E drejta për Ankesë

17. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.

18. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërisht relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.


Muja FERATI
Kryetar



12.12.2019
Datë